

EKSPOZE MBI TEZËN E NIVELIT TË MASTERIT NË INTEGRIME
EVROPIANE DHE ADMINISTRATË PUBLIKE

**ROLI I BASHKIMIT EVROPIAN NË EVROPIANIZIMIN E VENDEVE
TË BALLKANIT PERËNDIMOR PËRMES POLITIKAVE
KONDITIONALE – RAST STUDIMI REPUBLIKA E KOSOVËS**

NGA

BLINERA NUHIU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENI I SHKENCAVE POLITIKE

JANAR, 2022

ROLI I BASHKIMIT EVROPIAN NË EVROPIANIZIMIN E VENDEVE TË BALLKANIT
PERËNDIMOR PËRMES POLITIKAVE KONDICIONALE – RAST STUDIMI
REPUBLIKA E KOSOVËS

Mentor: Bardhok Bashota, Prof. Asoc. Dr

Politika e jashtme dhe zgjidhja e konflikteve është një përgjegjësi e cila kushtëzon krijimin e një infrastrukture të sofistikuar institucionale dhe ligjore, mbi bazën e politikave specifike, efektive dhe afatgjata. Procesi i zgjidhjes së konflikteve nga Bashkimi Evropian (BE), si një aktor i rëndësishëm ndërkombëtar i dedikohet përpjekjeve të vazhdueshme të shteteve anëtare të BE. Ky është një proces i cili ka qenë i vështirë në rrugëtimin e vet, themelet e të cilit rezultojnë herët në histori, nëpërmjet projektimit të një sërë planesh, projektesh, raportesh, analizash dhe traktatesh, projekte këto të cilat janë përballur me vështirësitë e kohës, dallimet kulturore, politike, juridike dhe frikës së delegimit të kompetencave si rrezik ndaj sovranitetit dhe krizës së identitetit kombëtar.

Politika e Jashtme e Bashkimit Evropian është një nga fushat më të diskutueshme të veprimtarisë së saj. Zhvillimi i hovshëm dhe sukcesi i arritur në zhvillimin ekonomik i BE ka bërë që të ketë dyshime rreth politikës së jashtme të saj. Politika e Përbashkët për Punë të Jashtme dhe Siguri (PPJJS) e Bashkimit Evropian, është themeluar me miratimin e Traktatit të Maastrich-it në vitin 1992, për të vazhduar me zyrën e Përfaqësuesit të Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe Përfaqësuesin e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri me Traktatin e Lisbonës e më vonë edhe instrumente tjera institucionale e ligjore. Përfaqësuesi i Lartë përfaqëson politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE në mbarë botën, duke realizuar dialog politik me vendet partnere dhe ato të treta, si dhe duke shprehur qëndrimin e BE në mbledhje dhe organizata ndërkombëtare. Në mënyrë që të vazhdonte zgjerimi dhe vendet të arrinin kriteret e parapara, BE kishte themeluar programin 'PHARE' i cili ishte program ndihmës për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Ky program ishte instrumenti kryesor financiar i strategjisë para-pranimit për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore të cilat kishin aplikuar për anëtarësim në BE. Mirëpo, edhe pse ky program kishte filluar së zbatuari në vendet e Ballkanit në maj të vitit 1999 BE miratoi një iniciativë të re për pesë vende të Ballkanit: Shqipërinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Republikën Federale Jugosllave, të quajtur Procesi i Stabilizim Asociimit. Procesi i Stabilizim Asociimit, i miratuar dhe vënë në fuqi më 1999, është korniza e politikave të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, në kuadër të së cilës zhvillohet procesi i integritit të këtyre shteteve në BE, deri në antarësimin e plotë të tyre.

Për hulumtimin e punimit janë themeluar hipotezat:

H 1: “Krahas zhvillimeve të hovshme në fushat e tjera, BE-ja ka pasur ngecje në politikën e saj të jashtme, sidomos në anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor”

H 2: “Politikat e Bashkimit Evropian kanë rol të rëndësishëm në evropianizimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor”

H 3: “BE mbetet nxitësi kryesor i ndryshimeve dhe reformave strukturore në Kosovë”

H 4: “Politikat e kushtëzimit janë mjeti më efikas përmes të cilave BE përpiqet të bëjë evropianizimin e Kosovës”

Pyetjet hulumtuese

Pyetjet hulumtuese të aplikuara për këtë studim dhe përmes së cilave do të arrihet deri të konkluzionet lidhur me temën janë:

- *Cilat janë instrumentet kryesore të politikës së jashtme të BE-së për veprim në raport me Ballkanin Perëndimor?*
- *Cilat kanë qenë Politikat e Bashkimit Evropian në evropianizimin e vendeve të Ballkanit perëndimor?*
- *Sa ka arritur BE ta realizoj pritshmërinë e saj fillestare në procesin e evropianizimit të Ballkanit dhe Kosovës në veçanti?*
- *Cilat janë pengesat kryesore të brendshme në Kosovë që po e sfidojnë agjendën e saj evropiane”*
- *Cilat janë sfidat e jashtme që e komplikojnë procesin e evropianizimit në Kosovë?*

Qëllimi i studimit

Qëllimi i hulumtimit është për të kuptuar më konkretisht zhvillimin e Politikës së Jashtme të BE-së, mekanizmat dhe rolin e tyre në Politikën e Jashtme.

Bashkimi Evropian kishte ofruar edhe asistencë për vendet e Evropës Jug-Lindore përmes programit ‚CARDS‘, me qëllim të pjesëmarrjes së tyre në procesin e stabilizim, asociimit me BE-në, program i cili nga janari i vitit 2007 ishin zëvendësuar me programin IPA. Ky program ishte instrumenti më i ri që BE ka ofruar për vendet candidate dhe candidate potenciale për periudhën 2007-2013, përmes së cilit Be ofron ndihmë komunitare prej së cilës përfitonin vendet e Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i këtij instrumenti ishte që të ndihmojnë këto vende të bëjnë përges drejt përmnushjes së kriterëve politike dhe skomike të Kopenhagës.

Krahas vendeve të tjera në Ballkan, BE kishte edhe një rol të konsiderueshëm në Kosovë. Kosovën e karakterizojnë dy faza të shtatndërtimit. Faza e parë është ajo nga viti 1999 deri më 17 shkurt 2008, përkatësisht periudha e administrimit ndërkombëtar nga OKB-ja dhe faza e dytë pas shpalles se pavarësisë e tutje. Administrimi ndërkombëtar nga OKB- ja bëhej përmes Misionit Civil ndërkombëtar – UNMIK, i cili ishte i autorizuar me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, pika 5.

Përveç rolit të rëndësishëm që BE kishte gjatë periudhës së administrimit të Unmikut në Kosovë, rol të rëndësishëm ka luajtur edhe në përgatitjen e procesit të bisedimeve dhe gjatë procesit. BE ka luajtur rol të rëndësishëm edhe në inicimin e procesit të bisedimeve. Në nëntor 2005 ministrat e jashtëm të vendeve të BE kanë diskutuar dhe shqyrtuar mundësinë e fillimit të bisedimeve në mes Kosovës dhe Serbisë. Gjatë procesit të bisedimeve angazhimi i Përfaqësuesit të atëhershëm Javier Solana kishte qenë i madh. Në fillim të bisedimeve ai ishte takuar me delegacionet e përfshira në proces dhe kishte udhëtuar në Prishtinë e Beograd, duke u bërë të qartë palëve negociuese rëndësinë e arritjes së marrëveshjes edhe për BE-në. Ai kishte biseduar me delegacionet e ndërmjetësimit por rëndësi të madhe i kishte kushtuar edhe ruajtjes së qetësisë dhe shmangjes së tensioneve, duke i bërë thirrje qytetarëve që të mos përdoret dhuna dhe duke deklaruar se zgjidhja e statusit të Kosovës do të garantoj që të gjithë qytetarët pa dallim etnie, të ndihen të qetë dhe të sigurtë. Njëkohësisht ai kishte paralajmëruar për një proces të gjate dhe sfidues. Mirëpo, edhe përkundër angazhimeve të palëve ndërmjetësuese dhe përkrahëse, nuk kishte arritur të arritur marrëveshje mbi statusin. Bisedimet përfunduan pa sukses edhe në fazën e dytë dhe Kosova shpalli pavarësinë. Edhe në këtë rast roli i BE ishte konstruktiv edhe pse shkak i pesë vendeve të cilat nuk e njohën pavarësinë. Nuk mund të vendoste si e vetme por shumica e shteteve (22 prej tyre), e njohën Kosovën shtet të pavarur dhe ishin përkrahës të saj.